

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti i përgjithshëm**, gjyqtarja e vetme gjyquese S. S., me procesmbajtësen Luljeta Luboteni-sekretare juridike, në lëndën penale kundër të akuzuarit N. K. nga fshati Z., Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KP-së, i akuzuar sipas aktakuzës së prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2374-3/2017 të datës 25.09.2017, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike me dt.26.10.2017, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Beqë Shala, të akuzuarit dhe mbrojtëses së tij av.N. M. nga Prizreni, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### AKT GJYKIM

#### I akuzuari:

N. K., nga i ati M. dhe e ëma Xh., e vajzërisë P., i lindur me .., në fshatin Z., Komuna e Rahovecit, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal ..

### ËSHTË FAJTOR

Se më datë 22.07.2017, rreth orës 00:10 minuta, në Prizren, në Lagjen “ .. mban në pronësi, kontroll ose posedim armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla, në atë mënyrë që gjatë zbatimit të planit operativ, zyrtarët e njësisë patrulluese policore, kanë ndalur për kontroll automjetin e markës “Sharan”, me targa të regjistrimit .. të cilin e drejtonte i akuzuari dhe në sirtarin e automjetit është gjetur një pistoletë e tipit “ECOL SPECIAL” modeli 99, me nr.serik EV-1420984, me kalibër të panjohur, ku në brendësi të pistoletës në karikator kanë qenë 6 fishek, duke vepruar në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët.

**Këso dore ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KP-së.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit të lartëshënuar dhe neneve 4, 6, 7,17, 41, 42, 46, 73 të KP-së, të akuzuarit i shqipton:

### DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej 700 € (shtatëqindë euro), të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimit me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim llogaritet me njëzetë (20) € gjobë.

Konform nenit 374 par.3 të KP-së, të akuzuarit N. K. i konfiskohet pistoletë e tipit “ECOL SPECIAL” modeli 99, me nr.serik EV-1420984, me kalibër të panjohur, si dhe 6 fishek së bashku me karikator -si objekte të kryerjes së veprës penale.

I akuzuari N. K. , obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.2374-3/2017 të datës 25.09.2017, kundër të akuzuarit N. K. nga fshati Z. , Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KP-së, dhe së bashku me aktakuzë, kësaj gjykate ja ka paraqitur edhe marrveshjen me shkrim mbi pranimin e fajësisë PP/II.nr. 2374-3/2017 të datës 25.09.2017.

Gjykata gjatë seancës së shqyrtimit të marrveshjeve mbi pranimin e fajësisë ka ndëguar të akuzuarin, mbrojtësen e tij dhe prokurorin e shtetit.

Prokurori i Shtetit-Beqë Shala gjatë seancës së shqyrtimit të marrveshjeve mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se qëndron pranë marrëveshjes së arritur në Prokurorin e Shtetit dhe të gjitha udhëzimeve që përmban e njëjta, meqenëse është lidhur konform dispozitave ligjore dhe njëherit ka propozuar që e njëjta të aprovohet duke shtuar se në kuadër të dënimit të rekomanduar, në vend ku është futur në kllapa shuma me shkronja prej shtatë mijë euro si në marrveshjen mbi pranimin e fajësisë duhet të jetë shuma “shtatëqindë euro” ashtu siç figuron edhe me numra.

Mbrojtësja e të akuzuarit N. K. -av.N. M. gjatë seancës ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrveshjes mbi pranimin e fajësisë e cila është lidhur pranë Prokurorisë Themelore në Prizren me dt.25.09.2017, meqenëse e njëjta është lidhur konform dispozitave ligjore të KPP-së, dhe paraprakisht është konsultuar me të mbrojturin e saj N. K. , ku edhe i ka sqaruar të gjitha pikat e marrëveshjes dhe bashkarisht janë pajtuar për një marrveshje të tillë duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovtoj.

I akuzuari N. K. gjatë seancës dëgjimore ka deklaruar se pajtohet me fjalët e mbrojtëses së tij.

Gjykata pas dëgjimit të pikpamjeve të prokurorit të shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtëses së tij, lidhur me pranimin e fajësisë sipas marrveshjeve mbi pranimin e fajësisë konstatoi se i akuzuari N. K. ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij av.N. M. i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë të pranuar edhe nga e të akuzuarit dhe se nuk ekzistonë asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e nenit 253 par.1 dhe 2 të KPP-së për hudhjen e aktakuzës.

Gjatë seancës rreth dënimit Prokurori i Shtetit Beqë Shala ka deklaruar se sa i përket dënimit të propozuar si në marrveshje mbi pranimin e fajësisë, një dënim i tillë është në proporcion me veprimet dhe veprën e kryer nga ana e të akuzuarit dhe është i mjaftueshëm me bindje se do të ndikojë tek i akuzuari që të mos kryej vepra tjera penale në të ardhmen.

Mbrojtësja e të akuzuarit N. K. -av.N. M. rreth dënimit i cili është propozuar në marrveshjen mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se, janë pajtuar për një dënim të tillë duke konsideruar se është i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit, njëherit ka shtuar se i mbrojturi i saj N. K. është i moshës së re, është penduar për veprimin të cilin e ka bërë

dhe premton se nuk do të përsërisë veprime kundërligjore dhe është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me ligjin.

I akuzuari N. K. rreth dënimit ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalët e mbrojtëses së tij.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit N. K., formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka ndëgjuar deklaratat e të gjitha palëve dhe ka pranuar dënimin e propozuar sipas marrveshjes mbi pranimin e fajësisë duke marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë posaqërisht rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata mori parasysh pranimin e fajësisë nga ana e tij, pendimin dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, moshën e tij të re dhe qëndrim korrekt para gjykatës. Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të shqiptimit, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 të KP-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe sipas bindjes së gjykatës ky dënim do të ndikojë mjaftueshëm tek i akuzuari dhe në rrethinën ku ai jeton që në të ardhmen të përmbahet nga veprime të tilla inkriminuese.

Vendimi mbi konfiskimin u muar konform nenit 374 par.3 lidhur me nenin 69 të KP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1834/2017, me datë 26.10.2017**

**Procesmbajtësja**  
Luljeta Luboteni  
*Luboteni*

**Gjyqtarja e vetme gjyquese**  
Sadije Selmani  
*Selmani*

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët nuk kanë të drejtën e ankesës për shkak të vendimit mbi dënimin dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesa për bazat tjera mund të ushtrohet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

*Exp. 07.29.11.2017*

*3 aktgjykime*  
*2 plotëdërgesa*  
*1 përkthyes*